



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 202300823/5**

**Tiranë** \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

**Lënda :**            *Rekomandim për analizimin e shkeljeve ligjore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Aldo Ndreshaj gjatë kryerjes së veprimeve procedurale me shtetasin V.F..*

**KOMISARIATIT TË POLICISË MALËSI E MADHE**  
**Koplik**

**DREJTORISË VENDORE TË POLICISË**  
**Shkodër**

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi V.F., lindur e banues në fshatin Koplik i Sipërm, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Malësi e Madhe.

Ankuesi shkruan se është shoqëruar në Komisarariat e Policisë Malësi e Madhe në datën 01.09.2023, në orën 07:00, ndërkohë që ndodhej në një bar-kafe të fshatit. Pas rreth 12 orë pyetjeje dhe veprime hetimore nga punonjësit e këtij komisarati është bërë arrestimi i tij duke e akuzuar për veprën penale “Vjedhje me dhunë”, mbetur në tentativë, të shtetasës R.H.. Ankuesi pretendon se gjatë veprimeve procedurale të kryera me të i janë shkelur disa të drejta ligjore, si mohimi i të drejtës për të pasur prezent një avokat, janë bërë disa montime faktesh, procesi i njohjes është bërë me fotografi dhe jo fizikisht, ndonëse në këtë komisarariat ka ambient të posaçëm për realizimin e njohjes, si dhe procesverbali i mbajtur për veprimin procedural të njohjes është i falsifikuar sepse vendi i kryerjes nuk është komisarati siç përshkruhet në përmbajtjen e tij por banesa e shtetasës R.H..

Gjithashtu ankuesi pretendon se në kallëzimin e bërë, shtetësja R.H. ka deklaruar se ajo e ka goditur me një karrige personin që ka tentuar t’i vjedhë me dhunë banesën dhe se i ka shkaktuar hemoragji. Ankuesi shtron pyetjen se, nëse do të kishte ndodhur kështu,

përse nuk është bërë vendimi për ekspertimin e tij mjekoligjor nëse ka pasur ndonjë plagë apo dëmtim tjetër nga goditja e bërë atij nga kallëzuesja.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, gërma “b” ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, në nenin 20 ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror”*, si dhe në paragrafin e fundit të nenit 19 ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”*, i kërkuam Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe që të na dërgonte një informacion lidhur me këtë ankesë dhe konkretisht parashtruar pyetjet si vijon:

1. Për cilën vepër penale është arrestuar shtetasi V.F. në datën 01.09.2023 dhe çfarë provash ka pasur në ngarkim të tij?
2. Cili është vlerësimi i bërë nga gjykata lidhur me arrestimin e tij në flagrancë, i ligjshëm apo jo?
3. Cili është qëndrimi i kësaj strukture të policisë lidhur me pretendimin e ankuesit se gjatë procesit të arrestimit të tij dhe kryerjes së veprimeve procedurale me të, i është mohuar e drejta e mbrojtjes me avokat, se procesverbali i paraqitjes për njohje është falsifikuar lidhur me vendin e kryerjes së tij?
4. A ka në Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe sistem monitorimi me kamera dhe nëse po, a funksionon ai?
5. A është regjistruar ankuesi në regjistrin e personave të shoqëruar në këtë komisarariat dhe sa orë është mbajtur ai në gjendje shoqërimi në datën 01.09.2023?
6. Në cilën orë është arrestuar ankuesi, referuar procesverbalit të arrestimit në flagrancë, regjistrin të shoqërimit dhe regjistrin të personave të arrestuar/ndaluar?
7. A është marrë vendimi nga OPGJ-ja për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të ankuesit për të vërtetuar faktin nëse ka pasur ndonjë plagë apo dëmtim tjetër ai nga goditja me karrige bërë atij nga kallëzuesja?

Bashkë me informacionin kërkuam edhe dërgimin e fotokopjeve të formularit të raportit të shoqërimit, të fletës së regjistrin të shtetasve të shoqëruar në polici në të cilat janë

pasqyruar gjenealitetet e ankuesit, të procesverbalit mbi veprimet e kryera me personat e shoqëruar, si dhe të dokumenteve të administruara lidhur me këtë rast.

Komisariati i Policisë Malësi e Madhe me shkresën nr. 1606/1 prot., datë 30.10.2023 ndërmjet të tjerave na informoi se:

1. Shtetasi V.F. është arrestuar për veprën penale “Vjedhja me dhunë”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 139 e 22 të Kodit Penal, pasi shtetësja R.H. ka deklaruar se ky shtetas i ka hyrë në banesë dhe e ka goditur në kokë e në duar me karrige disa herë. Pasi është bërë paraqitja për njohje me anë të fotografisë, shtetësja R.H. në të tre provat e kryera sipas procedurës përkatëse e ka identifikuar shtetasin V.F..

2. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër e ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin e shtetasit V.F. dhe ka caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arrest në burg”.

3. Fillimisht shtetasi V.F. është pyetur si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit, procedurë kjo që nuk kërkon pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës. Ndërsa në momentin që është vënë në dijeni se do të pyetet në cilësinë e personit ndaj të cilit do të zhvillohen hetime, ai ka deklaruar se nuk ka avokat dhe se do të shprehet në një moment të dytë.

4. Komisarati i Policisë Malësi e Madhe disponon sistem monitorimi me kamera në pjesën e jashtme të tij, në ambientin e dhomave të shoqërimit dhe në ambiente të tjera të brendshme.

5. Shtetasi V.F. është shoqëruar në ambientet e Komisariatit Malësi e Madhe në orën 08:30, të datës 01.09.2023 dhe në gjendje shoqërimi është mbajtur 8 orë e 30 minuta.

6. Ky shtetas është arrestuar në orën 17:00 të datës 01.09.2023.

7. Nuk është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor të shtetasit V.F., pasi sipas deklarimeve të shtetases R.H., ajo është goditur nga shtetasi V.F. dhe jo e kundërta. Ndërsa shtetasi V.F. në deklarin e tij është shprehur se nuk ka qenë tek banesa e shtetases R.H.. Ndërkohë ai nuk ka shfaqur pretendime se është dëmtuar, si dhe nuk ka pasur shenja lëndimi apo dëmtime në pamjen e jashtme.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se në lidhje me rastin në fjalë dhe për çdo veprim procedural të kryer është komunikuar në vazhdimësi me prokurorin e çështjes, z. Vatë Staka.

Së bashku me informacionin Komisarati i Policisë Malësi e Madhe na dërgoi edhe fotokopje të dokumentacionit të përpiluar në lidhje me këtë rast si: Procesverbalin e arrestimit në flagrancë të shtetasit V.F. në datën 01.09.2023, ora 17:00; Proceverbalin e marrjes së të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime; Proceverbalin e

marrjes së të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale; Formularin e raportit të shoqërimit ose ndalim/arrestimit; Proceverbalin e veprimeve të kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar. Ndërsa fotokopja e fletës së regjistrit të shtetasve të shoqëruar në polici në të cilat janë pasqyruar gjenealitetet e ankuesit, nuk na u dërgua.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, i përgjigjes së dërguar nga Komisarati i Policisë Malësi e Madhe dhe dokumentacionit bashkëlidhur konstatohet se:

Veprimet e punonjësve të Komisaratis të Policisë Malësi e Madhe lidhur me këtë rast, si shoqërimi në komisarati të shtetasit V.F. dhe kryerja e veprimeve të tjera procedurale (marrja e deklarimeve të tij, paraqitja për njohje, etj.), janë kryer pas njoftimit të bërë në këtë komisarati nga shtetësja R.H. rreth orës 01:30 të datës 01.09.2023. Kjo shtetase ka deklaruar se një person kishte hyrë në banesën e saj dhe e kishte goditur me karrige në kokë dhe në duar dhe pas kësaj ishte larguar. Gjithashtu ajo ka deklaruar se e ka njohur personin që e ka goditur, shtetasin V.F..

Shoqërimi i tij është bërë nga patrulla e policisë e përbërë nga Gac Melaj dhe Anton Malotaj, të cilët pas shoqërimit kanë përpiluar edhe formularin e raportit të shoqërimit të shtetasit V.F.. Referuar këtij raporti rezulton që shoqërimi i këtij shtetasi në komisarati është bërë në orën 08:30 të datës 01.09.2023.

Pas shoqërimit të këtij shtetasi në komisarati, nga oficeri i policisë gjyqësore Aldo Ndreshaj janë kryer veprimet e nevojshme procedurale për të provuar kryerjen e veprës penale nga shtetasi V.F..

Në përfundim të këtyre veprimeve oficeri i policisë gjyqësore ka krijuar bindjen e mbështetur në prova se shtetasi V.F. është autori i kryerjes së veprës penale “Vjedhja me dhunë” të shtetases R.H., mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 139 e 22 të Kodit Penal.

Referuar proceverbalit të arrestimit në flagrancë të shtetasit V.F. rezulton se ai është arrestuar në orën 17:00 të datës 01.09.2023. Pra, pas 8 orë e 30 minutash nga shoqërimi i tij në ambientet e policisë.

Avokati i Popullit vlerëson se kjo praktikë nuk është e bazuar në ligj dhe duhet ndryshuar. Ne jemi të vetëdijshëm se për rastin në fjalë, kryerja e veprimeve hetimore e procedurale nga policia gjyqësore kërkonte kohën e nevojshme për të bërë të mundur kërkimin, gjetjen dhe administrimin e provave në ngarkim të të dyshuarit si autor i veprës penale të vjedhjes me dhunë, mbetur në tentativë. Por referuar nenit 109/2<sup>1</sup> të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe Kreut V, pika 1, 2<sup>2</sup> të Procedurës

---

<sup>1</sup> 2. *Personi i shoqëruar nuk trajtohet në të njëjtat kushte me personin e ndaluar ose të arrestuar dhe, në çdo rast, shoqërimi duhet të zgjasë deri në sqarimin e çështjes, por jo më shumë se 10 orë.*

<sup>2</sup> V. “PËRGJEGJËSITË E PUNONJËSIT TË POLICISË NË RASTET E SHOQËRIMIT DHE ZBATIMI I AFATEVE”.

standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kufiri maksimal kohor i mbajtjes së një personi ndaj të cilit aplikohet masa e shoqërimit nuk mund të jetë më shumë se 10 orë.

Nëse për një person të shoqëruar në organet e policisë do të vendoset arrestimi apo ndalimi i tij për shkak se ndaj tij janë krijuar dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se është autor i një vepre penale, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet shënohet çasti (ora) i kapjes së tij në fakt kur ai është privuar realisht nga liria dhe jo ora kur përpilohet akti i arrestimit. Bazuar në nenet 144, 250 të Kodit të Procedurës Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Po ashtu, në bazë të nenit 258 të KPP, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Përveç sa më sipër theksojmë se, në rekomandimet e bëra në vijimësi nga Avokati i Popullit, si për rastet e ankesave të trajtuara ashtu edhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit është kërkuar që, edhe në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit duhet të vihet ora e shoqërimit të tyre dhe jo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit. Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale respektivisht nenet 144, 250, 258 dhe 259 të tij. Është e nevojshme që të sqarohet se këto rekomandime janë vlerësuar të drejta dhe janë pranuar nga Policia e Shtetit.

Nga këqyrja e proceverbalit mbi veprimet e kryera nga punonjësi i policisë me personin e shoqëruar, konstatojmë se ai është plotësuar por nuk është nënshkruar as nga përpiluesi i tij dhe as nga personi i shoqëruar. Në vlerësimin tonë ky fakt provon se ai nuk është plotësuar në kohën e duhur menjëherë pas përfundimit të veprimeve procedurale. Përderisa është i pa nënshkruar, ai është i pa vleftshëm dhe konsiderohet se nuk është bërë e dhënë personit të shoqëruar.

Ky qëndrim/mosveprim vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe me Kreun e VII-të, pika 1, gërma “a.3” të Procedurës

---

*1. Punonjësi i policisë ka të drejtë të aplikoje masën e shoqërimit dhe mbajë në mjediset e policisë një person për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin apo sqarimin e rrethanave në ngarkim të tij, por jo më shumë se 10 orë.*

*2. Afati 10 orësh është kufiri maksimal kohor i mbajtjes së një personi.*

*Në rast se verifikimet e nevojshme (identifikimi dhe sqarimi i rrethanave) përfundojnë në një kohë më të shkurtër se sa është afati maksimal, oficerit të policisë i paraqiten dy mundësi:*

*a. Të lirojë menjëherë të shoqëruarin;*

*b. Të kryej ndalimin/arrestimin e tij, në bazë të nenit 253/2 dhe nenit 251/3 të Kodit të Procedurës Penale;*

standarde të punës<sup>3</sup> “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ndërsa referuar gjermës “a.3.4”, paragrafi i fundit të saj, mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.

Është rasti të theksojmë se kjo shkelje e të drejtës ligjore të të shoqëruarve nga punonjësit e policisë dhe e detyrimit të këtyre të fundit është evidentuar edhe më parë nga ana jonë. Ndonëse në disa rekomandime që u janë adresuar në vijimësi nga institucioni i Avokatit të Popullit strukturave vendore e qendrore të Policisë së Shtetit është trajtuar ky shqetësim dhe është rekomanduar përmirësimi i punës, me keqardhje konstatojmë se raste të tilla përsëriten në praktikën e përditshme.

Ndërkohë, lidhur me justifikimin e bërë nga organi juaj në pikën 3 të përgjigjes së dërguar institucionit tonë, ku shpreheni se “fillimisht shtetasi V.F. është pyetur si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit, procedurë kjo që nuk kërkon pjesëmarrjen e avokatit mbrojtës..”, ju sjellim në vëmendje se referuar Kreut VI, pika 1, të Procedurës standarde të punës të cituar më sipër, në të gjitha rastet e shoqërimit, punonjësit e policisë janë të detyruar të njohin dhe zbatojnë të drejtat e personit të shoqëruar, si dhe japin siguri për jetën, shëndetin, kushtet e qëndrimit dhe trajtimin human në këto ambiente.

Ndërsa referuar nenit 109, pika 3<sup>4</sup>, të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe gjermës “e” të pikës 1 të Kreut VI, të kësaj Procedure, personat e shoqëruar kanë të drejtën ligjore që të komunikojnë me një person të besuar, avokat apo mbrojtësin ligjor. Pra, referuar dispozitave të këtyre akteve rezulton se punonjësit e policisë kanë detyrimin që ta njohin personin e shoqëruar me të drejtat e tij ligjore që në momentet e para të shoqërimit në mjediset e policisë. Dhe nëse i shoqëruari, pavarësisht arsyes së shoqërimit dhe cilësisë së pyetjes së tij, kërkon të komunikojë me një person të besuar, avokat apo mbrojtës ligjor, punonjësit e policisë janë të detyruar që të zbatojnë e respektojnë këtë të drejtë ligjore të tij të garantuar nga ligji.

### **<sup>3</sup> VII. “PROCEDURA TË DOKUMENTIMIT TË VEPRIMIT TË SHOQËRIMIT”**

#### ***a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:***

***a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.***

***a.3.2 - Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.***

***a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.***

***a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.***

**Mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.**

<sup>4</sup> 3. Personi i shoqëruar ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e shoqërimit. Ai/ajo duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me një person të besuar dhe avokatin.

Të gjitha këto çka analizuar më lart, tregojnë se nuk njihen në nivelin e duhur aktet normative ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe detyrimet e punonjësve të policisë për të zbatuar e respektuar të drejtat e shtetasve të shoqëruar në mjediset e Policisë së Shtetit.

Gjithashtu vlerësojmë se një ndër shkaqet e përsëritjes së këtyre shkeljeve të të drejtave të qytetarëve është edhe mos ushtrimi i kontrollit të strukturave drejtuese të punonjësve të policisë ndaj vartësve të tyre.

Theksojmë se qëndrimet jo ligjore të mbajtura në këto raste nga punonjësit e policisë cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky organ, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ***si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend***, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi nga strukturat e Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të shoqëruar në ambientet e komisariateve/stacioneve të policisë në përputhje me aktet normative në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave të nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësit të Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe, oficerit të policisë gjyqësore Aldo Ndreshaj për shkeljen e dispozitave të KPP, nenit 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe të Kreut VII-të, pika 1, gërma “a.3” të Procedurës standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin e praktikës aktuale në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit apo ndalimit orën faktike kur ata janë privuar nga

liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbalit përkatës, si dhe e drejta për të komunikuar me avokat apo mbrojtës ligjor.

3. Marrjen e masave të nevojshme nga drejtuesit e Komisarariatit të Policisë Malësi e Madhe dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër për të ushtruar kontroll në mënyrë të vijueshme në të gjitha strukturat vendore të policisë lidhur me zbatimin dhe respektimin e të drejtave ligjore të të shoqëruarve, duke përfshirë edhe përpilimin dhe dhënien e procesverbalit për veprimet e kryera me të shoqëruarit.

4. Marrjen e masave të nevojshme për trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë efektive të strukturave tuaja lidhur me njohjen e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi, rastet dhe kriteret e shoqërimit dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore të organit tuaj me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen dhe për të garantuar besimin e vazhdueshëm të publikut tek ky organ i administratës publike.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**

Konceptoi: S. Nushi